

VENDIM
Nr. 34, datë 6.7.2022

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR RITJEN E PËRQINDJES SË
PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONARIT “EUROSIG” SHA NË
KAPITALIN E BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA**

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës “e”, të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të shkronjës “h”, të pikës 1, të nenit 24, dhe nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes influencuese nga 21.02 për qind në 51.017 për qind të aksioneve, me të drejtë vote të aksionarit “EUROSIG” sh.a. në kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kushtin që brenda datës 31.12.2022:

a) Aksionari “EUROSIG” sh.a. të kontribuojë me mjete likuide në kapitalin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., në shumën 3 milionë euro;

b) Aksionari i tërthortë “EURO-ALBA-EA” sh.p.k. të sistemojë situatën me detyrimet tatimore.

2. Ngarkohet Banka e Bashkuar e Shqipërisë të njoftojë Bankën e Shqipërisë për plotësimin e kushteve të mësipërme.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për botimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko